



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 839/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Gjilan, paraqitur kundër kandidatit të pavarur Yll Isufi në Gjilan, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 12.11.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Gjilan.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 12.11.2013, se në Qendrën e Votimit 0402D /03R kandidati për kryetar Yll Isufi ka marë 300 vota qka mendojm se kjo nuk është e mundur andaj kerkoj që kjo (QV) të rinumrohet. Në bazë të nenit 25 të Rregullores 09/2013. PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### Ankesa është e pabazuar

PZAP-i, gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë, ngase pohimet e lartëcekura nga parashtruesi i ankesës nuk janë objektive, me të cilat vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, për arsye se nuk është ofruar asnjë dëshmi me të cilën do të vërtetohej një pretendim i tillë ankimorë, shikuar sipas dispozitës së nenit 3.6 pika c) e Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it duke marr parasysh arsyet e sipërsëhuara PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu administruar si provë relevante prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 839/2013 më datën 12.11.2013.



**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.